



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 211 prot.

Korçë, më 12.01 . 2023

**URDHËR**

Nr. 18 , datë 12.01 . 2023

**Për përzgjedhjen e subjektit/subjekteve që do të licencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë**

Bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 64, pika a; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 11, pika 7 dhe 8; vendimi i Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, "Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar;

**URDHËROJ:**


1. Kalimin në konkurs të hapur për përzgjedhjen e subjektit / subjekteve, në linjat e rregullta rrethqytetëse të miratuara me vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 17, datë 03.03.2017, të ndryshuar, në të cilat nuk ka subjekt të licencuar, për operuar në linjën përkatëse (sipas tabelës bashkëlidhur).
2. Dokumentacioni që duhet të dorëzojë subjekti për pjesëmarrjen në konkurs do të jetë në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, neni 9:
  - a. Kërkesa.
  - b. Formulari i vetëdeklarimit.
  - c. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
  - d. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
  - e. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
  - f. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.
  - g. Çertifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë se një mjet).
  - h. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B.
  - i. Leja e qarkullimit (për çdo autobus).
  - j. Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus).

- k. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve (për çdo autobus).
  - l. Çertifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus).
  - m. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus).
  - n. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus).
  - o. Leja e drejtimit.
  - p. Çertifikata e Aftësisimit Profesional.
  - q. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij).
  - r. Kontrata me agjensinë për transport udhëtarësh brenda vendit.
  - s. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Korçë, mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në periudhën e mëparshme).
3. Kriteret për klasifikimin e subjekteve, në rast se ka më shumë se një aplikant për linjën përkatëse, do të jenë sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 111, datë 11.10.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e subjektit kandidat për të operuar në linjat e rregullta rrethqytetëse, të specializuara dhe vajtje-ardhje të transportit rrugor të udhëtarëve".
  4. Njoftimi për zhvillimin e konkursit, kriteret e klasifikimit, dokumentacionin që duhet dorëzuar dhe afati për dorëzimin e tij, të kryhet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare, facebook dhe stendën e lajmërimeve të Bashkisë Korçë. Gjithashtu njoftimi të afishohet edhe në stendat e lajmërimeve në të gjitha Njësitë dhe Rajonet Administrative të Bashkisë Korçë.
  5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri më datë 27.01.2023.
  6. Komisioni Vlerësues për përzgjedhjen e subjektit kandidat, do të përbëhet nga :
 

Kletjon Kita	Kryetar.
Klajdi Jaçe	Anëtar.
Nikolin Lika	Anëtar.
  7. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komisioni i mësipërm, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimit Qytetar, Njësitë dhe Rajonet Administrative të Bashkisë Korçë.
  8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**

Sotiraq Filo



**I. NJËSIA ADMINISTRATIVE QËNDËR BULGAREC**

1.	LINJA NR. 1/3	Shamoll – Korçë – Shamoll	1 (një) automjet
----	---------------	---------------------------	------------------

**II. NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË**

1.	LINJA NR. 2/3	Dardhë – Korçë – Dardhë	1 (një) automjet
----	---------------	-------------------------	------------------

**III. NJËSIA ADMINISTRATIVE LEKAS**

1.	LINJA NR. 3/1	Lekas – Korçë – Lekas	1 (një) automjet
2.	LINJA NR. 3/2	Marjan – Korçë – Marjan	1 (një) automjet

**IV. NJËSIA ADMINISTRATIVE MOLLAJ**

1.	LINJA NR. 4/4	Pulahë – Korçë – Pulahë	1 (një) automjet
----	---------------	-------------------------	------------------

**V. NJËSIA ADMINISTRATIVE VITHKUQ**

1.	LINJA NR. 5/3	Shtyllë – Vithkuq – Shtyllë	1 (një) automjet
----	---------------	-----------------------------	------------------

**VI. NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË**

1.	LINJA NR. 7/3	Lavdar – Korçë – Lavdar	1 (një) automjet
----	---------------	-------------------------	------------------